



Përveç vlerave të jashtëzakonshme universale, **autenticiteti dhe integriteti** i Trashëgimisë kulturore janë faktorë kyq.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

FORMULAR PROPOZIMI

**Paraqitja e Asetit të Trashëgimisë Kulturore për Përcaktim në Mbrojtje të Përhershme
Trashëgimi Arkeologjike, Arkitekturore, Peizazhkulturor**

EMËRTIMI ZYRTAR I ASETIT TË PROPOZUAR

Municipium Ulpiana-Justiniana Secunda

Fotografi pamje karakteristike, dt.2015



Data/t kryesore të themelimit të asetit: Parahistori, Antikitet, Periudha e sundimit Romak, Antikitet i Vonë

Periudha/t historike: Periudha e sundimit Romak, Antikitet i Vonë (Shek. I-VI)

Adresa, Qyteti/Fshati, Komuna

Rruga Graçanicë-Llapllasellë, Ulpiana Antike, Komuna Graçanicë

Lloji i asetit të propozuarKategoria: **Trashëgimi Arkeologjike**Nënkategoria: **Lokalitet Arkeologjik**

Numri i inventarit (unik): 002120

Numri i regjistrimit në KKTK

Statusi i mbrojtjes ligjore të mëhershme/ referenca e dokumentit/aktit nëse ka

Vendim Nr. 21/55, më datë: 22.4.1955; Ulpiana në vitin 1990 shpallet Monument i**Rëndësisë së Veçantë.****LMMP 2011-2015 (MKRS)****ARSYESHMËRIA RRETH VENDOSJES SË ASETIT NË MBROJTJE TË PËRHERSHME**

Të përshkruhet arsyetimi se përse asemi i propozuar konsiderohet i rëndësishëm dhe duhet të vendoset në mbrojtje të përhershme.

E banuar nga dardanët që nga kohërat e lashta parahistorike, Ulpiana ishte kolonizuar nga romakët që në shekullin e parë pas krishtit, ishte shndërruar në Municipium në shekullin e dytë dhe gjatë periudhës së antikitetit të vonë u krijua si seli episkopate. Gjatë periudhës së sundimit romak, (shekujt I-IV) Ulpiana u zhvillua në një qendër të madhe ekonomike dhe pati një zhvillim sidomos gjatë shekujve III-IV, kjo falë revireve të pasura minerare në rrethinë të saj, por më pas, gjatë shekujve IV, V dhe VI, u gjend nën sulmet e kohë pas kohës të fiseve të ndryshme si Hune, Gote dhe Sllave, që e dëmtuan dhe shkatërruan qytetin të cilën edhe e plaçkiten. Qyteti pësoi një dëmtim të madh si në objekte dhe po ashtu në njerëz nga një termet shumë i fuqishëm që e kishte tronditur në vitin 518, por gjatë periudhës së sundimit të perandorit bizantin me origjinë dardane, Justiniani i Madh (vitet e sundimit, 535-565) Ulpiana, u ndërtua dhe rindërtua dhe u njoh me emrin e ri *Justiniana Secunda*. Sulmet e vazhdueshme të Sllavëve ndikuan që të krijohej një pasiguri për jetesë për popullatën dardane, andaj edhe u braktis në fillim të shekullit të shtatë dhe më vonë, gjatë mesjetës e deri në ditët e sotme, areali i Ulpianës-Justiniana Secunda, u shfrytëzua dhe shfrytëzohet për punime bujqësore dhe kryesisht për kultivime të drithrave.

Lokaliteti arkeologjik Ulpiana-Justiniana Secunda, është një lokalitet shumëvlerësor që në shtrirjen kohore përfshinë periudhën e mileniumit të parë para Krishtit, nga lashtësia dardane e deri në mesjetën e hershme. Gjurmët e rrënojave zbuluar, monumentet e ndërtuara gjatë periudhave të ndryshme historike, pasqyrojnë një histori të gjatë dhe të begatë si dhe përfaqësojnë periudha dhe faza të ndryshme të vazhdimësisë së jetesë që është një arkiv i kujtesë antike të cilën duhet ruajtur, mbrojtur dhe prezantuar për vizitorët e sotëm dhe posaçërisht për gjeneratat e ardhshme. Për më tepër, asetet dhe vlerat e përgjithshme dhe të veçanta arkeologjike dëshmuara në këtë lokalitet arkeologjik e posaçërisht të qytetërimit antik të sinkretizmit të kulturave dardane, romake dhe bizantine, plotësojnë kushtet që kjo qendër arkeologjike të shpallet park arkeologjik me vlera të çmuara nacionale dhe ndërkombëtare.

Areali i përgjithshëm i 'Parkut Arkeologjik' Ulpiana-Justiniana Secunda, përfshinë një sipërfaqe prej 1.4 Km², kurse Zona Mbrojtëse (Buffer Zone) është 3 Km². Pra, e tërë sipërfaqja prej 3km²

(300 Hektarë) duhet mbrojtur nga ndërtimet apo të ndërmerrën masa mbrojtëse dhe preventive për të parandaluar zhvillimi, ndërtime, germime dhe ndërhyrje ilegale apo inadekuete brenda perimetrit mbrojtës të saj. Këtu mund të kryhen punime bujqësore për kultivimin e drithërave (në pronësi private) por që mund të lëvrohen vetëm siç e parasheh Ligji Nr. 02/L-88, dhe jo më thellë se 30 cm, por në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar as edhe një aktivitet tjetër ndërhyrës që mund të cenojë integritetin stratigrafik të lokalitetit arkeologjik. Duhet theksuar se aktualisht nën administrimin e Institutit Arkeologjik të Kosovës është sipërfaqja vetëm e 2.77 Hektarë.

Ulpiana me rrethinën e saj përbën një peizazh të veçantë kulturore, e cila është zhvilluar organikisht gjatë shumë shekujve dhe për shkak të veçantisë së saj, ky lokalitet i posaçëm arkeologjik meriton të shndërrohet në një park arkeologjik dhe duhet të ketë mbrojtje të përhershme institucionale dhe ligjore si dhe duhet që të jetë nën mirëmbajtje të përhershme.

Kriteret e përzgjedhjes sipas së cilave është propozuar aseti

Lokaliteti arkeologjik Ulpiana-Justiniana Secunda përmban vlera të rëndësishme arkeologjike, në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtar. Si një lokalitet shumëvlerësor, Ulpiana është njëra nga qendrat më të rëndësishme arkeologjike në vendin tonë dhe në rajon. Gjatë periudhës së metaleve (Epoka e Bronzit dhe Hekurit) e deri në ardhjen e romakëve, Ulpiana ishte një vendbanim më i vogël i tipit opidum. Viteve të fundit janë zbuluar edhe disa gjurmë sporadike të periudhës neolitike që edhe mund të jenë gjurmët e para të jetesës në këtë vend.

Lokaliteti arkeologjik Ulpiana është i veçantë si në aspektin arkeologjik ashtu dhe në atë arkitektural dhe kulturor, duke ngërthyer traditat arkitekturale të ndërtimeve sipas traditës romake, pastaj asaj paleokristiane përkatësisht bizantine. Edhe vet lokacioni ku gjendet/shtrihet ky lokalitet arkeologjik është një peizazh i veçantë.

Specifikimi/përshkrimi i kriteres sipas Nent4, Rreg.Nr.5.2008/MKRS

Vlerat arkeologjike: Hulumtimet, kërkimet arkeologjike të zhvilluara në Ulpianë gjatë gati pothuaj 60 vite shfaqin gjurmë të shumta të trashëgimisë së jashtëzakonshme e të begatë arkeologjike. Që nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar e këtej, qyteti antik i Ulpianës ka qenë në vazhdimësi areal studimi nën llupën dhe kazmën e arkeologëve vendorë, por edhe të huaj, dhe deri më tani janë zbuluar disa monumente kulturi dhe objekte sakrale, pjesë të mureve rrethuese së bashku me kullat mbrojtëse, castrum apo garnizoni ushtarak romak, disa varreza, pastaj qindra fragmente që së bashku ofrojnë dëshmi për zotësitë artistike dhe aftësi inxhinierike të banorëve të saj në kohërat antike e që datojnë nga periudha e sundimit romak e më pas edhe gjatë sundimit Bizantin. Vlerat e lartpërmendura e shndërrojnë Ulpianën në njërin prej pikave kryesore të referimit në peizazhin kulturor dhe vizuel të Komunës së Graçanicës në veçanti dhe të Rajonit të Prishtinës në përgjithësi. Ulpiana ka vlera të larta arkeologjike sepse është një burim i pashtershëm i potencialit arkeologjik ku gjenerata të tëra arkeologësh e studiues të fushave relevante ndërdisciplinare mund të punojnë dhe të studiojnë.

Vlerat historike: Lokaliteti arkeologjik i Ulpianës me lashtësinë dhe autenticitetin e rrënojave, strukturave të objekteve dhe gjurmëve tjera të ruajtur *in situ* deri në ditët e sotme, paraqet një dëshmi të zhvillimeve kulturore, historike dhe arkitekturore gjatë pjesës së parë të mileniumit të

parë. Në shekullin e V, Ulpiana u bë një qendër peshkopate dhe ishte nën kontrollin dhe administrimin bizantin; ajo u fortifikua dhe strukturat e konsiderueshme e hershme të krishterë janë ndërtuar. Pas një periudhe të zhvillimit, në fund të shekullit të VI dhe fillim të shekullit të VII si pasojë e invasionsve dhe sulmeve Avare dhe Sllave, qyteti u braktis.

Vlerat Artistike: Lokaliteti arkeologjik i Ulpianës shquhet për vlera cilësore artistike e estetike, të artit muziv tek dyshemeja e bazilikës peshkopale që përbëhet nga mozaik polikrom të cilësisë së lartë, me modele gjeometrike, pastaj janë evidentuar paraqitja e dy zogjve, mozaik me ornamentim të kryqeve dhe gjithsej ka 22 mbishkrime në latinisht. Këto janë mbishkrime përkushtuese me emrat e donatorëve. Edhe tek kompleksi i banjës romake, përkatësisht tek pjesa e portikos së tempullit antik, dhe poshtë dyshemesë së bazilikës me kriptë, janë dëshmuar gjurmë të mozaikëve me ornamentime gjeometrike edhe këto polikrome. Poashtu vlera artistike vërehen tek statujat e punuar sipas artit të portretizimit romak dhe statujave të fragmentuara me vlera estetike, këto të veçanta për teknikën e punimit dhe raritetin e tyre. Lokaliteti posedon vlera të larta estetike si nga teknikat e ndërtimit ashtu dhe nga dekorimet e dokumentuara të elementeve origjinale të objekteve e gjurmëve të ndërtesave zbuluar *in situ*.

Vlerat Shkencore: Bazuar në gjetjet e materialit të llojllojshëm arkeologjik, studimeve kërkimore ndërdisiplinare (gjeomagnetike, gjeoelektrike) dhe mbështetur në të dhënat e burimeve të shkruara, të dhëna këto të sinkretizuara së bashku e të cilat janë analizuar dhe studiuar në vazhdimësi, ofrojnë dëshmi të pazëvendësueshme për traditën kulturore të civilizimeve antike, dhe janë burime të shumta shkencore të cilat na reflektojnë gjurmët e lashtësisë së lokalitetit arkeologjik të Ulpianës dhe më gjerë. Ulpiana ka qenë dhe do jetë një areal i interesit të veçantë për studiues të shumtë dhe të ndryshëm e posaçërisht atraktiv për studimet dhe hulumtimet ndërdisiplinare.

Përveç vlerave të jashtëzakonshme universale, **autenticiteti dhe integriteti** i lokalitetit arkeologjik të Ulpianës janë faktorë kyq për vlerën dhe rëndësinë e saj.

Propozuesi:

Institucioni: Instituti Arkeologjik i Kosovës

Emri/ Mbiemri: Enver Rexha Nënshkrimi :

Adresa dhe kontakt informacione: Pallati i Muzeut të Kosovës/ Instituti Arkeologjik i Kosovës
Rruga “Nazim Gafurri” pa numër, 10000 Prishtinë

Tel: 044/ 115-423

Email: enverrexha@gmail.com

Data : / /

Bashkangjitur: Lista e të dhënave dhe dokumentacioni

1. Të dhënat mbi lokacionin e asetit

2. Të dhënat mbi asetin
3. Propozim deklarata e rëndësisë
4. Gjendja e asetit
5. Mbrojtja dhe menaxhimi i asetit/Masat juridike dhe teknike
6. Monitorimi
7. Dokumentacioni përcjellës

Pranimi

Nr. protokolit .../.../... Dt..../.../.....


Zyrtari përgjegjës

Emri Nënshkrimi

1. LOKACIONI I ASETIT

Komuna, Qyteti/Fshati/Adresa

Ulpiana është njëra nga qendrat më të mëdha antike urbane në Republikën e Kosovës dhe gjendet rreth 7 km në jug-lindje të Prishtinës, (Komuna e Graçanicës, Rajoni i Prishtinës), e pozicionuar ne tokat qe sot i takojnë fshatrave të Graçanicës, Hajvalisë dhe Llaplla Sellës. Lokaliteti arkeologjik shtrihet në më pak se 1000 metër në perëndim të manastirit të Graçanicës, në një rrafshinë idilike që kufizohet në veri nga lumthi Graçanka dhe në jug nga kodrat e Drenocit.



Shtojcë1: A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse

Koordinatat gjeografike - Latituda/Longituda

7514383.417; 4717263.120 (Sistemi koordinativ zyrtar i RKS, KosovaRef1)


Përshkrimi tekstual i situacionit të asetit të propozuar, me linjëzim të perimetrit territorial dhe zonës rrethuese për mbrojtje /buffer zone

Territori i ngushtë por edhe i gjerë i Ulpianës, karakterizohet nga disa toponime karakteristike (*Gradina, Beden, Guri i Bardhë, Çezma, Dranoc (dre), Thanisht, etj.*) që bartin pjesë të historisë, tregojnë realitete gjeografike të shkuara të këtij areali të caktuar, por, edhe hidronime (emërtimet e ujërave, burimeve, përrenjve, çezmave, liqeneve) dhe oronimet (emrat e maleve, kodrave, tokave, fushave). objekte të caktuara që lidhen ngushtë me jetën materiale, kulturore e shpirtërore të bashkësisë së tyre, për të vendosur në kujtesën kolektive.

Lokaliteti arkeologjik shtrihet në më pak se 1000 metër në perëndim të manastirit të Graçanicës, në një rrafshinë idilike që kufizohet në veri nga lumthi Graçanka dhe në jug nga kodrat e Drenocit.

Qyteti i Ulpianës përfshinte një vendbanim të rrethuar prej mureve në një sipërfaqe prej 35,5 hektarë (1), por kësaj hapësire të madhe të qytetit duhet bashkangjitur edhe hapësira e *Castrum*-it (2) apo garnizonit fushor ushtarak romak që gjendej rreth 100 metra larg murit lindor të qytetit dhe që kapte një sipërfaqe prej 16 hektarësh (400 x 400m).

Gjithashtu në suburbiumin verior dhe atë perëndimor ndodheshin nekropoli verior, gjegjësisht *Memoria* (3) pastaj tuma në fushën Çerkeze (4), Nekropoli perëndimor. (5) si dhe Nekropoli jugor. Sidoqoftë, mendohet se Ulpiana së bashku me rrethinë-suburbium mbulonte një sipërfaqe prej rreth 120 hektarëve.



Qyteti antik i Ulpianës, është dëshmuar si një vendbanim shumështrësor, i ndërtuar në disa nivele, njëra sipër tjetres dhe me shtrese kulturore deri në 3.5 m thellësi. Qytetërimi i lashtë dhe antik në Ulpianë u zhvillua gjatë disa etapave të ndryshme kohore që nga parahistoria e deri në mesjetë për të shkëlqyer gjatë periudhës romake dhe pas një rënies të kobshme nga termeti shkatërrues i vitit 518, u ngrit si një feniks nga hiri në kohën e antikitetit të vonë, përkatësisht gjatë kohës së sundimit të Perandorit Justinian. Planimetria e vendbanimit të Ulpianës gjatë sundimit romak është vetëm pjesërisht e njohur. Derisa sa i përket topografisë, informacionet janë më të plotësuar sepse fatmirësisht ky lokalitet arkeologjik nuk është i populluar me një vendbanim modern dhe duke ruajtur karakterin agrar, i mbijetoi kohës dhe interakcionit njeri-vendbanim modern. Gjatë gërmimeve arkeologjike, gjithnjë është dëshmuar që në masën më të madhe vendbanimi antik është në rrënoja. Shtresat e dheut mbulojnë gjurmët e mureve në shtresë të thellë nga përafërsisht 1 në 1.5 m, kurse shtresat kulturore shpesh shkojnë deri në 3.5 m thellësi. Strukturat e lashta janë të mbuluar nga tokat/arat e lëruara në mënyrë periodike dhe vende vende me livadhe. Gjatë viteve, janë gërmuar me dhjetëra vende si brenda ashtu dhe jashtë qytetit. Qyteti ishte i fortifikuar me mure me trashësi deri në 3 m. Po ashtu nga ana planimetrike kishte formën e një drejtkëndëshi jo të rregullt. Objektet më të rëndësishme që janë zbuluara në Ulpianë janë: porta veriore së bashku me bedenat, pastaj përgjatë rrethit të gjerë të Ulpianës, përkatësisht jo larg bedenave të murrave rrethues, pozicionohen varreza veriore e ajo perëndimore dhe paraqitet përkatësisht suburbiumi apo paraqyteti. Nga monumentet kryesore zbuluar ndër dekada janë: bazilika paleokristiane, termat apo banjot romake, mbase gjurmët e një tempulli pagan që mbetet për tu konfirmuar se kujt i ishte dedikuar, rruga kryesore e qytetit Cardo Maximus apo prerja veri-jug së bashku me kanalin e shkarkimit të ujërave apo kloaka, dhe në lindje të qytetit të fortifikuar, gjendet garnizoni i fortifikuar ushtarak apo kastrum-i me një sipërfaqe prej 16.000 metër katror.

Perimetri i asetit të propozuar: **140 Hektarë**

Zona rrethuese për mbrojtje/Bufer zone: **160 Hektarë**

Sipërfaqja totale: **300 Hektarë**

Hartat dhe planet e situacionit

Shtojcë 2:

- *Planet e situacionit me shenjëzim të kufirit perimetral dhe zones rrethuese*
P=1:500 dhe 1:200.
- *Planet kadastrale të asetit të propozuar për mbrojtje dhe zones rrethit,*
shfrytëzuesit/pronarë dhe përdorimi i tokës.
- *Hartat topografike në shkallë të gjërë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe*
zonës së mbrojtur rrethit (buffer zone), gjeoreferencat në min tri pika, koordinatat,
shënimi i pjesës, orientimi, projeksioni, emri i pronarit dhe data.
- *Me qëllim të përfshirjes së asetit në GIS, informatat gjeografike digjitale për kufirin e*
perimetrit të asetit dhe zones rrethit të paraqitë në form vektoriale.

2. PËRSHKRIMI I ASETIT

Përshkrimi i elementeve përbërëse të asetit, përfshirë ndërtesën/strukturën apo ndërtesat/strukturat, stratografinë dhe elementet tjera ndërlidhëse me asetin

- *Përshkrimi i asetit të propozuar nga momenti i propozimit, duke specifikuar përmbajtjen e të gjitha elementeve dhe karakteristikat domethënëse të tyre ndërlidhur me atributet e trashëgimisë kulturore.*
- *Në rastin e trashëgimisë arkitekturore (monument, ansambël apo lokalitetet) dhe të trashëgimisë arkeologjike (monument, ansambël, lokalitet apo rezervat) të bëhet përshkrimi i të gjitha elementeve ndërlidhëse të asetit në kuptimin e veçorive të trashëgimisë kulturore. Në këtë kuadër përfshihet përshkrimi i ndërtesës/strukturës ose ndërtesave/strukturave, planimetritë, sistemi i ndërtimit, stili arkitekturor, proporcionet, ritmi, enterieri, materialet, datimi dhe aspektet tjera ndërlidhëse të lokacionit të aseti, siç janë tereni, oborri, mobiljet, pikturat, mbishkrimet, mjedisi rreth tij, etj.*
- *Në rastet e qyteteve ose të një kuarti historik, të bëhet përshkrimi i ndërtesave historike kryesore të karakterit publik dhe plani i bazës së sipërfaqës perimetrale të asetit me përshkrimin e mjedisit rrethues.*
- *Ndërlidhur me lokalitetet apo rezervatet arkeologjike dhe artin shkëmbor, të bëhet përshkrimi i peizazhit mjedisor. Ndërsa, peizazhi kulturor të përshkruhet njëjtë si në rastet e lartëshënuara, duke përqëndruar vëmendjen nëspecifikat e interakcionit historik ndërmjet natyrës dhe njeriut.*

Lokaliteti antik dardan, romako-bizantin i Ulpianës është pa mëdyshje njëra nga qendrat më interesante arkeologjike në Kosovë dhe rajonin e gjërë të gadishullit Ilirik. Njëra nga arsytet e shfaqjes dhe pranisë së romakëve në këtë rajon mbi të gjitha ka të bëjë me pasuritë dhe burimet me metale të çmueshme dhe nevojave të mëdha që perandoria Romake kërkonte për kohën në fjalë. Vendndodhja e kësaj qendre në afërsi të depozitimeve të minierave të pasura me metale të çmueshme, në mes të tokave pjellore me një pozitë kyçe gjeo-strategjike në udhëkryqin e rrugës antike që lidhte lindjen me perëndimin, i dhanë kësaj qendre një rendësi specifike që nga themelimi i saj e deri në mesjetë.

Gjurmët e para të jetës në Ulpianë, të dëshmuara nga gërmimet arkeologjike, zënë fill që në epokën e tranzicionit nga periudha e bronzit në atë të hekurit. Të dhënat arkeologjike dhe burimet historike të autorëve antik, kryesisht grek e romak, tregojnë se formën e një qendre urbane Ulpiana e kishte ravijizuar disa dekada pas pushtimit që Roma i bëri Mbretërisë Dardane. Kjo qendër transformohet nga një vendbanim i lashtë dardan apo opidum i koncentruar rural, në një vendbanim të gjerë dhe të hapur të organizuar urban, ku fillojnë të shfaqen atributet e një qyteti tipik romak.

Gjurmët e para të jetës në Ulpianë, të dëshmuara nga gërmimet arkeologjike, zënë fill që në epokën e tranzicionit nga periudha e bronzit në atë të hekurit. Të dhënat arkeologjike dhe burimet historike të autorëve antik, kryesisht grek e romak, tregojnë se formën e një qendre urbane Ulpiana e kishte ravijizuar disa dekada pas pushtimit që Roma i bëri Mbretërisë Dardane. Kjo qendër transformohet nga një vendbanim i lashtë dardan apo opidum i koncentruar rural, në një vendbanim të gjerë dhe të hapur të organizuar urban, ku fillojnë të shfaqen atributet e një qyteti tipik romak. Kërkimet arkeologjike dëshmojnë mbi ekzistencën e një veprimtarie prodhuese të xehetarisë në këtë qytet që para ardhjes së romakëve, ndërsa për origjinën e

Ulpianës është supozuar se qyteti është ndërtuar mbi një vendbanim më të hershëm, i cili nga një vendbanim i vogël xehetarë u transformua në një nga qendrat kryesore të Dardanisë. Nisur nga burimet e shkruara mendohet se themelimi i qytetit të Ulpianës lidhet, ndonëse tërthorazi, me perandorin Trajan pikërisht në kohën e zbatimit të politikës së urbanizimit intensiv e cila përfshiu dhe Dardaninë, në kuadër të Mezisë së Epërme (Moesia Superior). Perandori Trajan, emri i plotë i të cilit ishte Marcus Ulpius Trajanus sundoi në vitet 98-117, dhe mund të supozohet se ndoshta për nder të tij edhe u emërtua qyteti i Ulpianës. Megjithatë sipas disa të dhënave të shkruara, është menduar se në vitin 169 mbas Kr, Ulpiana ka fituar statusin e municipit (Municipium Ulpianum), ndonëse për këtë sipas studiuesit N. Ceka, Ulpiana e fiton statusin e municipit vetëm gjatë sundimit të perandorit Hadrian (117-138 mbas Kr.). Sidoqoftë, ky qytet zhvillimin më të madh e ka arritur në mesin e shekujve III dhe IV, periudhë në të cilën Ulpiana ishte jo vetëm një stacion perandorak Stat(ionis) Ulp(ianensis), por dhe një qendër e fortë politike, ekonomike dhe kulturore e gjithë Dardanisë. Gjatë kësaj periudhe kohore qyteti gëzonte epitetin Municipium Ulpiana Splendissima. Tashmë Ulpiana ishte urbanizuar me një rrjet rrugor sipas sistemit ortogonal, ujësjellës, objekte banimi, objekte publike, sakrale, profane e utilitare. Po ashtu ajo gjithnjë ka ruajtur statusin e një qendre urbane me rëndësi metalurgjike, zejtare, tregtare e bujqësore gjatë 5 shekujve të parë të mileniumit të parë. Gjatë kësaj periudhe, Ulpiana luante një rol specifik në rrugët komunikuese të gadishullit Ilirik, si urë lidhëse në mes Konstandinopolit dhe Romës, përkatësisht, detit Adriatik dhe detit Egje e deri me detin e Zi.

Shtojcë 3:*Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në P= 1:200, përfshir planimetrit dhe prerjet kryesore, fasadat karakteristike, aksonometria (mundësisht), dhe fotografi karakteristike të enterierit dhe eksterierit.*

Funksioni (përdorimi) aktual /Shfrytëzuesi/t/Pronësia e ndërtimeve dhe tokës

Hulumtime arkeologjike-Instituti Arkeologjik i Kosovës

Toke bujqësore private-bujq dhe pronarët e tokave punuese

Rëndësia/vlera/t

Vlerat Historike: Lokaliteti arkeologjik Ulpiana paraqet vlera të veçanta për periudhën antike në Kosovë dhe më gjerë. Siç dihet, vendndodhja e kësaj qendre në afërsi të depozitimeve të minierave të pasura me metale të çmueshme, në mes të tokave pjellore me një pozitë kyçe gjeo-

strategjike në udhëkryqin e rrugës antike që lidhte lindjen me perëndimin, i dhanë kësaj qendre një rendësi specifike që nga themelimi i saj e deri në mesjetë.

Vlerat Artistike: Sa i përket vlerave artistike lokalitetin e bën unik arti muziv i mozaikëve zbuluar tek termat (mozaik polikrom me ornamentime gjeometrike që i përkasin dhe tempullit antik me portiko) pastaj mozaiku polikromi paleokristian tek Bazilika Peshkopale, etj.

Vlerat Shkencore: Bazuar në gjetjet arkeologjike, arkitekturore dhe të gjetjeve të luajtshme, konstatimet shkencore të cilat janë arritur janë të shumta. Hulumtimet në Ulpianë vazhduan edhe pas vitit 2000, përpos Institucioneve dhe arkeologëve Kosovar¹, në Ulpianë u kyqën edhe profesionist në bashkëpunim edhe me studiues shqiptar², francez³, gjerman⁴ dhe së fundmi turq⁵ në kuadrin e bashkëpunimeve ndër-institucionale ndërshtetërore.

Që nga viti 2008, në Ulpianë ka filluar të praktikohet hulumtimi ndërdisiplinor⁶.

Për pesë vite me radhë (2008-2012), falë një bashkëpunimi të arritur përmes Memorandumit të nënshkruar në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përfaqësuar nga Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Muzeu i Kosovës dhe në anën tjetër Instituti Arkeologjik Gjerman, Frankfurt/Main, përveç gërmimeve arkeologjike, janë zhvilluar edhe incizime gjeomagnetike. Prospektimi, përkatësisht incizimet e fundit gjeofizike në këtë areal (mbi 50 Ha) dhanë rezultate shumë të frytshme shkencore, këto jo vetëm në interes nacional por edhe ndërkombëtar, prandaj me të drejtë e bënë këtë qendër arkeologjike shumë atraktiv për studiuesit vendor, ata të huaj dhe për vizitorët e shumë dashamirës të trashëgimisë kulturore arkeologjike.

Kërkimet e viteve të fundit, po sqarojnë gjithnjë e më shumë rëndësinë që kishte kjo qendër për territorin dardan dhe më gjërë. Natyrisht zbulimet e shumta dhe angazhimi i disa ekipeve arkeologjike dhe konservuese po krijojnë dora-dorës mundësinë për ngritjen këtu të një parku me

¹ Universiteti i Prishtinës, Muzeu i Kosovës, Instituti për Mbrojtje të Monumenteve - Muzeu Rajonal i Prishtinës dhe Instituti Arkeologjik i Kosovës.

² Instituti Arkeologjik i Tiranës, Shqipëri.

³ Universiteti Pierre Mendes France, Grenoble 2, France.

⁴ Instituti Arkeologjik Gjerman, Frankfurt/Main.

⁵ Universiteti Mimar Sinan, Stamboll, Turqi.

⁶ Deri me tani, që nga viti 2008, përpos incizimeve gjeofizike/gjeomagnetike të udhëhequra nga Dr. Friedrich Lueth-Dr. Felix Teichner, Instituti Arkeologjik Gjerman, Frankfurt/Main, janë zhvilluar edhe survey në hinterlandin e Ulpianës dhe në zonat minerare si dhe po zhvillohen studime/analiza arkeometalurgjike e hulumtime të minierave antike nën udhëheqjen e Dr. Guntram Gassmann dhe Dr. Gabriele Körlin (Muzeu i Bochum-it, Gjermani). Janë dërguar mostrat e zgjyrës për analiza në Laboratorin e Mineralogjisë, Departamenti i Petrologjisë dhe Gjeokimisë në Universitetin Goethe-Frankfurt/Main, mostra këto që po analizohen nga Dr. Sabine Klein. Pastaj është përdorur teknologjia e Terrestrial Laser Scanning nga porta veriore dhe duke ndjekur linjën veriore është ndjekur vija Cardo Maximus deri tek rrjedha e lumit Graçankë. Gjithashtu janë bërë shpime (nga 5 deri 10 metër thellesi-sistemi KAROT) si brenda ashtu dhe në hinterlandin e Ulpianës, për mostra (ekofakte, biofakte dhe gjeofakte) Gjeoarkeologjike, Arkeobotanike, këto të zhvilluara nga Universiteti i Hajdelbergut, Instituti i Gjeografisë dhe Gjeografisë Fizike-Gjermani të udhëhequr nga Prof. Dr. Olaf Bubbenzer. Të dhënat e analizave të marra nga Ulpiana gjate verës së vitit 2010 dhe të kryera me metodën Radiokarbon C14 nga Dr. Felix Bittmann në Institutin Arkeologjik në Wilhelmshafen të Gjermanisë konfirmuan ekzistencën e një vendbanimi 500 vjet p.e.s. në këtë lokalitet. Të gjitha këto aktivitete ndër-disiplinore janë paraparë të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Për më tepër, këto metoda dhe praktika që janë në zhvillim e sipër hapin perspektiva të reja për mënyrën e hulumtimit si dhe prodhojnë rezultate me kualitative. Natyrisht që pas përfundimit të studimit, analizimit dhe verifikimit të të gjitha të dhënave të mbledhura do të publikohen në të ardhmen.

vlera të veçanta arkeologjike me rëndësi për rajonin sipas shembullit të parkut arkeologjik në qytetin antik *Colonia Ulpia Traiana* në Xanten të Gjermanisë, që është i njohur edhe si njëri nga muzetë më të mëdha të hapur arkeologjike në botë.

Kriteret/vlerat/ interesi

- *Përshkrimi i atributëve/vlerave të asetit sipas kriterëve të përcaktuara në Nenin 4, të Rreg.Nr.5.2008/MKRS)*

Lokaliteti arkeologjik i Ulpianës i përmban të gjitha vlerat e rëndësishme arkeologjike, artistike, shkencore, shoqërore, shpirtërore dhe teknologjike. Me zbulimin e pagëzimorës oktagonale, mund të thuhet se paraqet edhe një raritet duke qenë se pagëzimorja/baptisteri është ekzemplari i vetëm i zbuluar në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Kategoria e rëndësisë

- *Lokale, nacionale, ndërkombëtare.*

Zhvillimi historik i asetit

- *Përshkrimi i formësimit të asetit ngatërshet eliminimin e gjendjeve aktuale, duke specifikuar ndryshimet, transformimet, demolimet apo rindërtimet dhe ndërtimin e historisë së konservimit.*
- *Ndërlidhur me asetet e trashëgimisë arkitekturore dhe arkeologjike, të bëhet paraqitja e fazave kryesore ndërtimore për monumente, ansamble dhe lokalitete. Peizazhi kulturor, të përshkruhet sipas të dhënave të lartëshënuara, duke përfshirë aspektin e historisë së aktivitetit të jetës natyrore.*

3. PROPOZIM DEKLARATA E RËNDËSISË NË PËRPUTHJE ME ATRIBUTET DHE VLERAT

- *Atributet dhe vlerat që paraqet asetit, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 4, Rreg. Nr.05, 2008, MKRS.*
- *Analiza komparative e aseteve të njëjta në nivelin lokal, nacional dhe më gjërë*
- *Autenticiteti/Integriteti*

Që në vitin 2006 është përcaktuar vizioni për Ulpianën si lokalitet arkeologjik dhe destinacion turistik atraktiv dhe gravitues i një rajoni më të gjerë të trashëgimisë kulturore. Vlerësimi Teknik Preliminar 2006 (VTP) propozon të ashtuquajturin “Ansambli i Integruar Kulturor i Ulpianës” (Ulpiana’s Integrated Cultural Ensemble - UICE) i cili do të përmbledhë në vetë 1) Ulpianën, 2) Manastirin e Gracanicës, 3) Kalanë e Veletinit, 4) Lokalitetin Neolitik të Glladnicës 5) Galerinë dhe Muzeun e minierave në Kishnicë, si dhe 6) një muze të ri të Ulpianës, i cili do të fitonte rolin e pikës qendrore (fokale) të Ansambli në fjalë, 3 në të cilin ansambël më tej përfshihet areali i minierave antike të Shashkocit dhe qyteza e Janjevës. 4 Ky koncept vazhdon të jetë aktual edhe në ditët e sotme; për më tepër, është kompatibil me konceptin e bazuar në Qasjen ‘Peisazhi Urban Historik’ (Historic Urban Landscape, HUL), miratuar nga UNESCO në nëntor 2011. 5 Ajo që mbetet për ta shndërruar këtë vizion në projekt të zbatueshëm është definimi dhe hartëzimi i territorit që është subjekt i propozimit për qasjen e bazuar në peisazh historik (një shembull i studimit për implementim të qasjes HUL të UNECOs është dhënë në kontekstualizimin e politikave dhe mjeteve bazuar në qasjen HUL (të listuara në dokumentin e Rekomandimit). Lokaliteti arkeologjik i Ulpianës që në vitin 1955 është futur në mbrojtje nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve. Kurse për ta vlerësuar rëndësinë e kësaj qendre në historinë e Kosovës, Ulpianës i është dhënë statusi i Monumentit të rëndësishë së veçantë në vitin 1990. Që nga viti 2011, Lokaliteti i Ulpianës gjendet në Listën e Monumenteve nën Mbrojtje të Ministrisë, Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës. Mbështetur në gjitha vlerat e veçanta që ka ky lokalitet i veçantë arkeologjik si dhe në mbështetje të planeve për shpalljen park arkeologjik, mendojmë se Ulpiana duhet të mbrojtje të përhershme dhe sigurisht që duhet punuar në përpilimin e planit të menaxhimit në mënyrë të funksionalizimit dhe shfrytëzimit të tij si një qendër arkeoturistike.



Peisazhi Urban Historik “UICE” – lokalitet potencial i Trashëgimisë Botërore
Burimi: F. Jerliu (2014)

4. GJENDJA E ASETIT/ FAKTORËT NDIKUES DHE RREZIKU

- Përshkrimi i gjendjes së ruajtjes të elementeve origjinale të asetit

- *Përshkrimi i gjendjes teknike*
- *Faktorët ndikues ndaj asetit, presionet e zhvillimit bashkohor, adaptimet, transformimet, demolimet, ndërtimet e reja, agrokultura, veprimet tjera ilegale, ndotja, fatkeqësitë natyrore, aksidentale, etj.*
- *Rreziku kryesor i këtij lokaliteti është vendshtirja e tij në toka bujqesore. Punimet bujqesore janë armiku kryesor i këtij lokaliteti, poashtu duhet të mos i harrojmë ndërtimet dhe hapjen e puseve, për ujitjen e tokës.*

5. MBROJTJA DHE MENAXHIMI I ASETIT/POLITIKA, MASAT JURIDIKE DHE TEKNIKE

- *Programet/Planet e promovimit, interpretimit, mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së autenticitetit/integritetit të asetit, duke specifikuar nevojën dhe planet për ndërhyrje hulumtuese, riparimi urgjent, restaurimet dhe adaptimet për përdorim bashkëkohorë.*
 - *Përdorimi i ndërtesës dhe shfrytëzuesit/pronari*
 - *Statusi i asetit në relacion me legjislacionin për planet e zhvillimit territorial dhe programet tjera zhvillimore.*
 - *Relacioni i mbrojtjes së asetit me Planet ekzistuese zhvillimore të qytetit, fshatit, Komunës dhe Planin Hapsinorë të Kosovës.*
 - *Sistemi i menaxhimit të asetit*
 - *Resurset financiare vjetore në dispozicion apo të nevojshme*
 - *Resurset profesionale në dispozicion dhe nevojat*
 - *Kushtet për vizitor dhe statistikat*
- Shtojcë4:** *Projekt propozimet për punë hulumtuese dhe teknike, dhe Plani i menaxhimit të asetit*


6. MONITORIMI/INSPEKTIMI

- *Përshkrimi i sistemit të monitorimit dhe inspektimit periodik i asetit, agjenda vjetore e inspektimit të asetit, mënyra dhe forma e raportimit me dokumentim*
- *Emërtimi i institucionit përgjegjës dhe kontakti adresë*

7. DOKUMENTACIONI PËRCJELLËS

- *Fotografi, slajda dhe material audiovizuel, në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Kopje e Formularit standard të regjistrimit të asetit në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore (ID Kartela).*
- *Kopje e Aktit të mëhershme mbi statusin ligjor të asetit.*
- **Shtojcë 1,** *A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse, formë të shtypur dhe digjitale.*
- **Shtojcë 2,** *Planet e situacionit të asetit me shenjëzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese, P=1:200 dhe P=1:500, në formë të shtypur dhe digjitale.*

- *Plani kadastral i asetiit të propozuar për mbrojtje dhe zones rreth tij, me paraqitjen e të dhënave për parcelt, shfrytëzuesit/pronarët dhe përdorimi i tokës.*
- *Harta topografike në shkallë të gjërë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe zones rreth tij (buffer zone), në formë të shtypur dhe digjitale.*
- *Informatat gjeografike digjitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zones rreth tij të paraqiten në form vektoriale.*
- **Shtojcë 3:** *Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në $P=1:200$, përfshir planimetrit dhe prerjet kryesore, fasadat (pamjet) karakteristike, aksonometria (mundësisht), dhe fotografi karakteristike të enterierit dhe eksterierit.*
- **Shtojcë4:** *Projekt propozimet për punë hulumtuese apo ndërhyrje teknike dhe Plani i menaxhimit të asetit të propozuar për mbrojtje*





Shtrirja e Komunës së Graçanicës në Republikën e Kosovës


ZK Graqanic

Aerofoto e vend shtrirjes së Ulpianës



Autori: Agjencia Kadastrale e Kosovës

Shkalla 1:4500



Harta topografike e vend shtrirjes së Ulpianës

KULTURNO NASLEDJE/TRASHËGIMIA KULTUROROE/CULTURAL HERITAGE



OPŠTINA GRAČANICA/
KOMUNA GRAČANICËS/
THE MUNICIPALITY OF GRACANICA

LEGENDA/LEGJENDA/LEGEND

SPECIJLNO ZAŠTIĆENA ZONA

ZONA E VEÇANTË E MBROJTUR
SPECIAL PROTECTED ZONE



ARHEOLOŠKO NALAZIŠTE

GJETJET ARKEOLOGJIKE
ARCHAEOLOGICAL SITE



VERSKI OBJEKTI

NDËRTESTAT FETARE
PLACES OF WORSHIP




GROBLJA


VARREZAT
CEMETERIES



Skala: 1:50,000



Perimetri i asetit të propozuar: **140 Hektarë** Zona rrethuese për mbrojtje/Buër zone: **160 Hektarë** Sipërfaqja totale: 300 Hektarë



Perimetri i asetit të propozuar: **140 Hektarë**·Zona rrethuese për mbrojtje/Bufer zone: **160 Hektarë**·Sipërfaqja totale: 300 Hektarë (Me parcelat)



Harta e Pronësisë në Zonën e Parë të Ulpianës (Zgjidhja ideale për arealin e Parkut Arkeologjik)

Parcelat në pronësi të shtetit	Parcela	Sip.m ²	Parcelat në pronësi private	Parcela	Sip. m ²	Parcelat e planifikuara për shfrytëzim	Sip. m ²
Nekropoli Verior	1093-2; 1094-2	3.188.812	Rruga [Pjesa 1] Stanisa (Slobodan) Petrivic	1092-0	130	859-0	1.925,41
Porta Veriore	1153-2; 1154-2	4.813.415	Rruga [Pjesa 2] Uros (Miroslav) Stevic	1091-0	160	Boban Todorovic 1083-2	5.267,54
			Rruga [Pjesa 3] Radovan (Aleksandar) Krstic	1090-0	52	1079-0	13.455,06
			Rruga [Pjesa 4] Slavisa (Dragomir) Krstic	1089-0	49	1075-0	2.859,06
			Rruga [Pjesa 5] Zivko (Cedomir) Velic	1086-0; 1085-0	85	1076-0	2.763,85
			Milorad Dimitrijevic	1084-0	3.650	1077-0	3.245,23
			Radomir (Tanasko) Kostic	1079-0	1471 + 158 rruga	1078-0	1.780,25
			Stanisa (Slobodan) Petrovic	1151-0	3.284	1153-1	3.055,60
			Momcilo Dimitrijevic	1152-1/2	949.921/ 1224	1154-1	5.363,43
			Nebojsa Djordjevic	1078-0	1.400	1155-1	2.690,99
			Svetislav (Bozidar) Djordjevic [rruga e gjate hyrese]	1078-0/a	1.400	1152-0	1.734,68
			Novica (Maksim) Popovic	1077-0	1303,217/1600	Hamdi Berisha P-73414019-00763-0	13.541,90
			Dragan (Cveta) Sekulic	1076-0	1310,714/ 1600	1086-0	784,484
			Dragisa (Momcilo) Popovic	1075-0	1459,637/1600	1085-0	801,593
			Miroslav (Cedomir) Kostic	1079-0	1514,977/1600	1088-0	4.812,29
						1059-0	447,755
Total Parcelat në pronësi të shtetit: 8002,227 m ² ; 0,8 ha			Total parcelat në pronësi private: 18182,647 m ² ; 1,8 ha			Total parcelat e planifikuara për shfrytëzim: 64529,107 m ² ; 6,45 ha	
Totali: 90713,981; 9,0 ha							

Pasqyra e pronësisë dhe shfrytëzimit aktual të parcelave të tokave në Ulpianë

ULPIANA



Ulpiana fotografuar nga droni (monumentet kryesore)



8. PËRGATITJA E FORMULARIT

Formulari u përgatit nga: [Milot Berisha \(Arkeolog\)](#)
Institucioni: [Instituti Arkeologjik i Kosovës](#)
Adresa: [Rr. Nazim Gafurri, 10000 Prishtinë, Kosovë](#)

Kontakt Tel/Faks/email,web faqe
Tel: [044 189 909](#)
Email: berishamilot@gmail.com

Data / /

Nënshkrimi

